



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Department of Slobodnih Profesija-
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.12/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore, lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr. 164/2017, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, pala ankuese nga dhe përfaqësuesit e tij, avokat dhe avokati nga Prishtina si dhe Përmbaruesi Privat, me datë 01.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-12/2023 i datës 12.04.2023 dhe ankesa e palës ankuese si të pabazuara.

II. Përmbaruesi Privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore, nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P.nr. 164/2017.

A r s y e t i m

Pala ankuese ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit privat me pretendimin se përmbaruesi privat ka bërë shkelje duke mos pasur parasysh kërkesat e debitorit sa i përket kërkesës për lartësinë e obligimit, kërkesës për ekspertizë financiare dhe vlerës së hipotekës, obligimin e paguar nga debitori e duke qenë i njëanshmën me palët, pasi ka mbrojtur vetëm palën kreditore gjatë kryerjes së veprimeve përmbarimore me qëllim të nxjerrjes në shitje dhe dorëzimit të paluajtshmërisë lëndore tek kreditori.

Duke u bazuar në këto si palë ankuese kanë parashtruar ankesë me pretendimin se përmbaruesi ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së.

I kanë propozuar komisionit që të ndërmirren masa ndaj përbaruesit privat .

Me datën 12.04.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar ndaj përbaruesit privat, lidhur me veprimet përbarimore për këtë lëndë.

Përbaruesi Privat, në deklaratën e tij e ka përshkruar rrjedhën e rastit,ku pas pranimit të propozimit për përbarim nga kreditori ,debitori ka parashtruar prapësim me datën 05.07.2017 ,mirëpo të njejtin me datën 07.07.2017 e ka tërhequr .

Pasi marrëveshja ka dështuar mes palëve, përbaruesi e ka caktuar ankandin publik,,mirëpo me kërkesë të palëve, ankandi është shtyer.Përsëri pas dështimit të marrëveshjes mes palëve me kërkesë të kreditorit është caktuar ankandi,mirëpo veprimet janë shtyer,pasi është kërkuar përjashtimi i përbaruesit tek ky rast.Pasi është refuzuar kërkesa për përjashtim janë ndërmarrë veprimet përbrimore në harmoni me dispozitat ligjore,gjë që dëshmohet me vendimet e gjykatave ku janë lënë në fuqi veprimet e përbaruesit lidhur me shitjen e paluajsthsmerisë lëndore.Pretendimet e palës ankuese janë jo të qarta dhe ta pa bazuara dhe vet fakti që iniciohet procedura pas 4 viteve,tregon që kemi te bëjmë me parashkrim dhe tregon jo seriozitet të debitorit.Këto pretendime lidhur me shkeljet ligjore më së miri i ka sqaruar Gjykata e Apelit,ndërsa sa i përket pretendimeve për fajde,përbaruesi nuk është kompetent, pasi që palët duhet t' i drejtohen organeve kompetente.

Në seancën dëgjimore palët kanë mbetur në tërësi sikurse në kërkesat e tyre të mëhershme. Përfaqësuesi i palës ankuese, avokati ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë parashtimeve të dhëna me shkrim pranë ankesës së paraqitur. E njoftoi komisionin dhe ia dorëzoi gjatë seancës kopjen e aktakuzës së dt 21 04 2020, ku pretendon se e njejtja do të zgjerohet edhe ndaj përbaruesit si shkak i keqpërdorimeve zyrtare . Poashtu komisionit ia dorëzoi edhe ekspertizën financiare të punuar për objektin lëndor të nxjerrë në procedurën penale me dt 04.03.2020 . Avoketët poashtu kanë theksuar se pavarësisht ekspertizës financiare dhe konstatimeve të ekspertit ashtu siç e kanë paraqitur në ankesë, përbaruesi privat ia ka lejuar vetes të bëjë kalkulimet lidhur me shumat në objektin lëndor sikurse kamata,vlerësimi i pronës, me çka përbaruesi privat ka rënë ndesh me mbrojtjen e dinjitetit të debitorit, sepse nuk i ka pranuar as pagesat që i ka kryer n shumën prej 91.700 euro.

Përbaruesi privat në seancë e mbajtur ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes së dhën me shkrim duke shtuar se këtu kemi të bëjmë me dy lëndë per faktin se ekzekutimi i detyrimit është kryer sipas lëndës, P.nr. 164/2017, ndërsa lirimi i objektit që po quhet sekuestrim, është në lëndë tjetër, gjë për te cilën sot nuk është përgaditur, pasi këtu behet fjalë për lëndën, P.nr.164/ 17. Përbaruesi poashtu ka theksuar se nuk e konsideron veten fajtor për asnjë nga pretendimet e palës ankuese. Sa i përket llogaritjes së kamatës ka parashtruar se është gabim të konsiderohet se përbaruesi privat nuk ka të drejtë të llogarit kamatën, e që në rastin konkret, përbaruesi privat nuk e ka llogaritur kamatën. Si provë e gjithë kësaj e ka potencuar faktin se i njëjti ka dërguar procesverbalin e datës 07.07.2023,të mbajtur në zyrën e përbaruesit privat në të cilën seancë palët e përfaqësuar secila me avokat, janë marrë vesh për detyrimin , kohën e pagesës si dhe tërheqjen e prapësimin.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përbaruesi Privat veprimet e fundit i ka ndërmarrë me dt.24.01.2019,që është Urdhëri i shitjes.

Duke iu referuar veprimeve të fundit komisioni konstaton se ankesa e parashtruar nga pala ankuese është parashtruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 375 të LPP-së, ku ceket se procedura disiplinore mund të filloj në afat prej 6 muajsh nga shkelja e bërë dhe jo më vonë se një vit nga dita e shkeljes. Mbi këtë bazë komisioni konstaton se ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor dhe nuk janë trajtuar fare pretendimet e palëve sa i përket shkeljeve të pretenduara.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.12/2023 datë 01.06.2023

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.